



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:132383

Datë: 22.10.2024

Numri i dokumentit: 06333563

KPPP.nr. 778/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Exclusive” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810502246, me seli në Prishtinë, rr. “Aziz Abrashi”, Zona Industriale, nr. 86, përfaqësuar nga V.L.K., kundër debitorit B.I. B.I., me numër unik identifikues 810346256 dhe seli në Bushatasit, Mitrovicë, p.nr., duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 191/24, i lejuar me datë 07.03.2024, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 22.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit B.I. B.I., me numër unik identifikues 810346256, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 191/24, i lejuar me datë 07.03.2024, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr.191/24, i lejuar me datë 07.03.2024, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Exclusive” Sh.P.K, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. FDP23-02524, e datës 28.03.2023; Faturës nr. FDP23-03864, e datës 09.05.2023; Faturës nr. FDP23-06720, e datës 31.07.2023, dhe; Faturës IL22-11912, e datës 19.12.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 191/24 të datës 07.03.2024, me të cilin është urdhëruar debitori B.I. B.I., që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 1,598.92, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar Urdhrin Përmbarrimor, me arsyetimin se kreditorin kanë pasur marrëveshja që pagesat të kryhen pas shitjes së mallrave dhe se debitori ka kthyer produktet e rrezikuara nga afati çka dokumentohet me fletë kthime dhe kartelë financiare. Ndërsa ka shtuar se me kreditorin i ofrojnë marrëveshje duke e ftuar që të bëjë tërheqjen e artikujve të furnizuar të cilët janë afër skadimit të afatit, ndërsa pjesën tjetër të detyrimit do ta përmbush brenda fatit 3 ditësh.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se e kundërshton prapësimin e debitorit, sepse nuk ka pasur asnjë marrëveshje mes palëve në lidhje me kthimin e mallrave, ndërsa ka shtuar se debitori prapësimin nuk i ka bashkangjitur asnjë provë. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzojë dhe Urdhrin Përmbarrimor ta lej në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se përmbarruesi privat ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave të cekura sikurse në hyrje të arsyetimit të aktvendimit, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Poashtu, gjykata gjen se të njëjtat fatura janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa janë pranuar, vulosur dhe nënshkruar nga debitori.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar Urdhri Përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e Urdhrit Përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 778/24, datë 22.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.